

AKT THEMELIMI

Sot ne dt.02 Prill 2022 me cilesine e "Ortakut te Vetem Themelues ",

ANASTASIOS LAINAS, i biri i Athanasios, i datelindjes 16/09/1965, i lindur ne Trikala-Greqi dhe banues ne Greqi,qyteti Trikala,Rruga Dragoumi nr.34, shtetas grek, madhor me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet Kartes se identitetit nr. AZ 768175 ,leshuar me date 03/03/2008,i cili me vullnet të lire të plote e të singerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ne ligjin "Per Qendren Kombetare te Biznesit", ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijon shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar, me emertimin **HISTRIA** shpk.

KREU I

Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja,Objekti

Neni 1

Emertimi

Emertimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **HISTRIA** shpk. Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqiptar.Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaku themelues.

Neni 2

Forma Juridike

Shoqeria **HISTRIA** shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria **HISTRIA** shpk, eshte nje e tille, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortakut i vetem që përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka seline ne adresen:

Lagj.Nr.1,Rr.Onhezmi, godina nr.92,kati i pare, Sarande,Qarku Vlore, Shqiperi.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me Vendim te Asamblese se Ortakut te vetem.

Neni 4

Objekti i veprimtarise

- 1.Aktivitet ne industrine e betonit të gatshëm, importet e çelikut, punimet teknike.**
- 2. Prodhimi dhe tregtimi i çdo lloj materiali ndërtimi, importi i këtyre mallrave si dhe eksporti i tyre drejt vendeve të huaja.**
- 3. Përfaqësimi i shoqërive tregtare e industriale greke dhe të huaja.**
- 4. Prodhimi dhe tregtimi i betonit të gatshëm, të tubave prej betoni, të blloqeve prej betoni, suvasë, tullave, vajrave, minerale dhe materialeve të tjera të ngjashme, pllakave, mermerit, materialeve të ndërtimit, drurit, hekurit, gozhdëve, qelqeve, alumineve, shtëpive të gatshme, urave, kontratave te punëve publike dhe private, produkte bujqësore e blegtorale, agrume, perime, patate, prodhimi dhe standardizimi i tyre, tregtimi i makinave, makinerive, turizmi, kontraktorët, të gjitha llojet e punëve të lidhura me to, pjesëmarrja e shoqërisë në çdo formë ligjore dhe marrja**

përsipër e përfaqësimit të kompanive vendase apo të huaja me qëllim të ngjashëm ose të krahasueshëm.

5. Ndërmarrja dhe realizimi i të gjitha llojeve të projekteve teknike të së drejtës publike, bashkiake ose private ose Organizatave ose Kooperativave të të gjitha llojeve si dhe ndërmarrjen dhe realizimin e të gjitha llojeve të studimeve dhe kërkimeve.

6. Ndërmarrja e menaxhimit teknik, projektimit, ekzekutimit dhe vënies në punë të projekteve teknike ose investimeve në përgjithësi

7. Ofrimi i shërbimeve të konsulencës teknike për çështjet:

- a) përpunimin e çdo lloj studimi teknik, ekonomiko-teknik ose ekonomik.
- b) ndërtimi i punimeve teknike të çdo kategorie.

8. Ndërtimi me çdo sistem, i ndërtesave dhe komplekseve të ndërtesave dhe shitja ose shfrytëzimi në çfarëdo mënyre i tyre.

9. Përfaqësimi tregtar i shoqërive vendase ose të huaja.

10. Tregtimi i çdo forme materialesh, makinerish dhe veglash me origjinë vendase ose të huaj.

11. Importi dhe tregtimi i gurëve të çmuar, metaleve dhe produkteve të tyre.

12. Tregtia e hidrokarbureve, vajrave dhe lubrifikanteve

13. Projektimi dhe zbatimi për ndërtimin e objekteve të ndryshme si dhe të ndërtimeve civile industriale, turistike, bujqesore dhe kompletimi me instalime të nevojshme me tuba betoni si dhe ata elektrike, hidraulike, sistemeve të ngrohjes, ujsjellesa, kanalizime, hapje trasesh të të gjitha llojeve në fushën e ndërtimit, ndërtim rrugësh, asfaltime etj. Shërbime të të gjitha llojeve në fushën e ndërtimit. Prodhim i materialeve të ndryshme betoni.

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendren Kombëtare të Biznesit (QKB).

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 lekë.

Kapitali i shoqërisë është 100 leke i përbërë nga 1 kuote dhe zotërohet nga ortakut i vetëm i shoqërisë. **Z. ANASTASIOS LAINAS**

Vlera totale e Kapitalit të Regjistruar është **100 Leke**

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortakut i vetëm themelues përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundërt të tregtueshme deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë;

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar mund të transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me Vendim të Asamblesë së Ortakut të vetëm.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirish të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë lirish të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve.

Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

KREU II
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8
Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakut te vetem themelues eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakut te vetem eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e Ortakut te vetem brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratori.

Neni 9
Administrimi

ANASTASIOS LAINAS, i biri i Athanasios, i datelindjes 16/09/1965, i lindur ne Trikala-Greqi dhe banues ne Greqi, qyteti Trikala, Rruga Dragoumi nr.34, shtetas grek, madhor me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet Kartes se identitetit nr. AZ 768175 ,leshuar me date 03/03/2008. Emerimi i administratorit eshte me nje afat pese vjeçar me te drejte riemerimi, i cili ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet e themelimit te shoqerise te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asamblese se ortakut te vetem te shoqerise.

Neni 10
Kompetencat

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht Asamblese se ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e ketij statuti që kufizojnë kompetencat e administratorit, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

Administratori ose ortaku që nuk janë persona juridikë nuk u lejohet të kontraktojnë në çfarëdo formë qoftë, të marrin hua te shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për paradhënie si dhe të bëhen dorëzënës apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

Neni 11
Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.

Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 12

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe dhe per çfaredo shkak, edhe para plotesimit të afatit per të cilin eshte krijuar siç mund të jene

a. Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimit të metejshem të veprimtarise se saj.

b. Ne nje nga menytrat e parashikuara nga ligji "Per Falimentimin"

c. Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare.

Ne kete rast Asambleja e Ortakut te vetem merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Neni 13
Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit Nr.9901 date 14.04.2008"Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil , Ligji per QKB, dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqiperise.

Neni 14
Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne tre ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku i vetem themelues i shoqerise tregtare **HISTRIA** shpk, nenshkruhet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij orgjinale.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË

ANASTASIOS LAINAS

